

AKT-THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ISABELLE ENERGY” SH.P.K

Tiranë 1 Maj 2024,

Sot, më datë 02.05.2024, unë i nënshkruari **Mentor Cami**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 15.10.1954, lindur ne Vicsht, Peshkopi dhe banues ne Tirane madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me ID nr. F41015167G, në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligjin nr.9901, nga 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”, ligji nr. 131/2015 datë 26.11.2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", i ndryshuar,

Krijon

sot nëpërmjet këtij akti një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur “**ISABELLE ENERGY**” Sh.p.k (më poshtë e quajtur “Shoqëria”), veprimtaria e së cilës do të rregullohet në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi dhe të këtij statuti të shoqërisë.

KAPITULLI 1

NENI 1

THEMELIMI, EMERTESA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA


Në Tiranë, më 1 Maj 2024 u krijua Shoqëria me Përgjegjësi të kufizuar e quajtur “**ISABELLE ENERGY**” SH.P.K, më poshtë e quajtur “Shoqëria”. Shoqëria fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar Shqiptar. Aksionarët e Shoqërisë janë: **Mentor Cami** shtetas shqiptar, i datëlindjes 15.10.1954, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me ID nr. F41015167G.

NENI 2

OBJEKTI I AKTIVITETIT TË SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë për objekt të veprimtarisë së saj kryerjen e çdo veprimtarie të lejuar nga ligji dhe/ose me pjesëmarrjen në çdo veprimtari apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar në bazë të legjislacionit shqiptar dhe në veçanti:

- Kerkim, zbulimit, nxjerrjes, prodhimit, shfrytezimit, transport dhe te tregtimit te mineraleve te ndryshme metalore dhe jo metalore si (krom etj) me shumice dhe pakice te eksportimport dhe ndermjetesim per tregje te mineralit te kromit, prodhim koncentratit, shpime nentokesore. Te ferrokromit, te koncentratit dhe mineralit te kromit, inpjant te perpunimit dhe seleksionimit te kromit. Ne fushen e perdorimit civil te lendeve plasese dhe shperthyese. Prodhimi, operimi dhe tregtimi i energjise elektrike.- Projektim, zbatim ,mbikqyrje te punimeve ne fushen e ndertimit te banesave, te objekteve civile dhe sociale, ushtarake dhe industrial dhe objekteve qe gjenerojne



Energji Elektrike (HEC, Centrale Fotovoltaike) .Projektim ndertim te rrugeve, hapje te reja zhavorime, asfaltime , ndertime te veprave te artit etj.Projektim dhe zbatim te veprave ujitesore si sistemi dhe mirembajtjen te veprave ujitesore, vepra marrje dhe aksesore dytesor. -Eksport-import te mallrave ,materiale ndertimi ,materiale drusore te te gjitha llojeve te perpunuar dhe pa perpunuar.Ndertime civile.

NENI 3 KOHËZGJATJA

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë të pakufizuar kohore.
Shoqëria “**ISABELLE ENERGY**” SHPK, gezon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti I regjistrimit si e tille ne regjistrin tregtar te QKB-se.
Shoqëria mund të ndërpritet ose të bëhet joaktive para këtij afati me vendim të Mbledhjes së Anëtarëve.

NENI 4 SELIA E SHOQËRISË

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Beqir Luga P 3/1, Shk 1, K3, AP 5 , Tiranë 1001.
Shoqëria mund të hapë degë, zyra dhe/ose të kryejë aktivitet në vende të tjera si brenda edhe jashtë Republikës së Shqipërisë sipas vendimit të Shoqërisë.



KAPITULLI II

KAPITALI

NENI 5 KAPITALI I SHOQËRISË

1. Kapitali aksionar është 100,000 lekë (njëqindmijë leke) barabarte me 1 (nje) kuote., i paguar plotësisht, me vlerë nominale 100,000 lekë.
2. Pjesëmarrja e aksionarëve ndahet si më poshtë:

Mentor Cami, shtetas shqiptar, i datëlindjes 15.101954, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me ID nr. F41015167G zotëron 100% të kapitalit.

Nr.	Emri I Ortakut	Kuota	Kontributi I ortakut	Perqindja ne kapital
1.	Z.Mentor Cami	1	100,000 LEKE	100%

Kontributet e anëtarëve mund të bëhen në para ose në asete (pasuri të paluajtshme ose të luajtshme ose të drejta). Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme në çdo moment sipas kushteve të parashikuara nga ligji shqiptar. Përgjegjësia e ortakut për detyrimet e shoqërisë shtrihet deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin e Shoqërisë.

NENI 6 RRRITJA DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT THEMELTAR

Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Shumica e anëtarëve nuk mund të detyrojnë asnjë nga anëtarët e tjerë të rrisin pjesën e tyre në kapitalin themeltar të Shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit aksionar mund të vendoset vetëm nga asambleja e ortakëve, në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e këtij Statuti.

Në çdo rast, ulja e kapitalit duhet të bëhet në përpjesëtim me aksionet e secilit prej Aksionarëve.

NENI 7 TRANSFERIMI I KUOTAVE

Aksionet e kapitalit të shoqërisë "ISABELLE ENERGY" SH.P.K. dhe të drejtat dhe detyrat e ndërlidhura mund të transferohen si më poshtë:

- a) Kontributit në kapitalin aksionar;
- b) Shitje dhe blerje;
- c) Trashëgimia;
- d) Dhurimi;



e) dhe çdo negociatë tjetër të përcaktuar me ligj. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në statutin e shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar kalohen me trashëgimi sipas ligjit në fuqi.

NENI 8 ORGANET VENDIMARRËSE

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë. Asambleja e ortakëve është organi i vetëm që miraton çdo ndryshim të statudit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Asambleja e ortakëve vendos për çështjet e mëposhtme:

- a. Vendimet për politikat ekonomike e tregtare të shoqërisë;
- b. Ndryshimet e Statutit;
- c. Emërimi dhe shkarkimi i administratorit.
- d. Emërimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar; dh. Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në pikat. c) dhe d);
- f. Mbikëqyrja e punës së kryer nga administratori, duke përfshirë kontrollin buxhetor dhe politikat e menaxhimit;
- g. Miratimi i pasqyrave financiare dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë;
- h. Zmadhimi dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i. Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j. Përfaqësimi i shoqërisë në gjykatë dhe në procedura të tjera kundër administratorit;
- k. Riorganizimi dhe likuidimi/prishja e shoqërisë;
- l. Miratimi i procedurave për thirrjen e Asamblesë;
- m. Çështje të tjera të kërkuara me ligj;

Anëtari mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme nëpërmjet një autorizimi të lëshuar për një person të tretë ose për një nga anëtarët e tjerë; Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtën rend dite.



NENI 9 MËNYRA E THIRRJES SË MBLEDHJES SË ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftimin nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë ose nëpërmjet postës elektronike, duhet të përmbajë vendin, datën, orën dhe rendin e ditës e duhet t'u dërgohet të gjithë anëtarëve të paktën 7 ditë përpara datës së caktuar për takimin.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur duke respektuar procedurën e përshkruar më sipër, vendimet janë të vlefshme vetëm nëse të gjithë aksionarët janë dakord me rendin e ditës, edhe nëse vetë thirrja nuk është e vlefshme.

NENI 10 KUORUMI

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosi për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë apo mjete elektronike sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njëjtën rend dite.

NENI 11 MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e përgjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrjes, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërive. Çdo ndryshim statusi duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

NENI 12 PËRJASHTIM NGA E DREJTA E VOTËS

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- Vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- Ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- Dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku të cilin përfaqëson.



NENI 13 ADMINISTRIMI

Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë individë si Administrator të Shoqërisë. Emërimi nuk mund të zgjasë më shumë se pesë vjet dhe është i rinovueshëm. Emërimi i tyre mund t'u vendoset palëve të treta pasi të regjistrohen në Regjistrin e Përgjithshëm.

Shoqëria do të administrohet nga z. **Mentor Cami**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 15.10.1954, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me ID nr. F41015167G, për 5 vitet e para të biznesit me të drejtë riemërimi.

Veprimet e administrimit të Shoqërisë përpara të tretëve do të konsiderohen të vlefshme nëse janë ndërmarrë dhe nënshkruar nga Administratori i saj. Administratori i Shoqërisë ka të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer çdo veprim dhe akt në kuadër të aktivitetit të Shoqërisë.

NENI 14 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori kanë të drejtë e detyrohen të:

1. Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
2. Vepron me të tretët në emër dhe për llogari të shoqërisë brenda kompetencave të parashikuara në Statut apo/dhe në ligjin "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";
3. Kryen emërimin dhe shkarkimin nga puna të punëmarrësve të shoqërisë;
4. Jep urdhra dhe udhëzime punëmarrësve dhe vendos saksione ndaj tyre, në përputhje me kontratat e punës dhe rregulloret e brendshme të shoqërisë;
5. Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë;
6. Përgatisin dhe nënshkruajnë pasqyrat financiare, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumenta përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
7. Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
8. Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
9. Raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
10. Kryejnë detyra të tjera të përcaktuar në ligj dhe në statut, të zbatojnë vendimet e marra nga asambleja e përgjithshme.



Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 15 PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT

1. Administratori është personalisht përgjegjës, kundrejt Shoqërisë dhe palëve të treta, në rast të shkeljes së ligjit dhe statutit ose veprimeve të tjera të paligjshme të kryera me dashje gjatë administrimit të tij. Administratori dhe ortakët që kanë ndërmarrë veprime ose kanë bërë marrëveshje të pamiratuara nga Asambleja e Përgjithshme, janë përgjegjës për pasojat që rezultojnë dhe janë personalisht përgjegjës për to.
2. Nëse administratori sillet në kundërshtim me detyrat dhe standardet profesionale, ai duhet të dëmshpërblejë Shoqërinë dhe të rimbursojë të gjithë shumën që ata dhe personat e lidhur me ta kanë bërë nga një sjellje e tillë.

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, EKSPERTET

NENI 16 VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në “Qëndrën Kombëtare të Biznesit” dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

NENI 17 EKSPERTËT

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë nga ortakët e shoqërisë.

Në përfundim të kontrollit dhe pas plotësimit të kësaj kërkesë, eksperti kontabël përgatit pasqyrat financiare vjetore ose një raport periodik, i cili duhet t'u dërgohet në kohë aksionerëve për miratim.

KAPITULLI V PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

NENI 18 PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj
- b) Me vendim të Asamblesë së Ortakeve;
- c) Me hapjen e procedurave të falimentimit;



d) Nëse ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;

e) Me vendim të gjykatës.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

NENI 19 RIORGANIZIMI I SHOQËRISË BASHKIMI-NDARJA

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

NENI 20 BAZA LIGJORE

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

NENI 21 MOSMARRËVESHJET

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptar.

ORTAKËT E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “ISABELLE ENERGY”

MENTOR CAMI

